



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V
Sesioni pranveror

Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale
Mbledhja nr. 20
Ndërtesa e Kuvendit, salla N - 302
Prishtinë, më 28 tetor 2015, në orën 14:00

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR SHËNDETËSI, PUNË
DHE MIRËQENIE SOCIALE

Në mbledhje morën pjesë: Flora Brovina, Fikrim Damka, Fadil Beka, Hatim Baxhaku dhe Adem Hoxha.

Munguan: Njomza Emini, Shukrije Bytyçi , Besa Baftiu dhe Time Kadrijaj.

Stafi mbështetës i Komisionit: Shpresa Haxhijaj, koordinatore e Komisionit dhe Muhamet Bytyçi, zyrtar i fushës.

Mbledhjen e kryesoi, Flora Brovina, kryetare e Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

REND I DITËS:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 30.9.2015;
3. Raportimi i grupeve punuese;
4. Të ndryshme.

Kryetarja e Komisionit, Flora Brovina, konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa asnjë ndryshim.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 30.9.2015

Kryetarja konstatoi se Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, miratoi procesverbalin e mbledhjes së Komisionit, të mbajtur më 30.9.2015, pa vërejtje.

3. Raportimi i grupeve punuese

Kryetarja, së pari ia dha fjalën kryesuesit të grupit punues për Projektligjin për Shërbimin mjekësor emergjent, deputetit Hatim Baxhaku.

Hatim Baxhaku – Grupi punues e ka shqyrtuar projektligjin në disa takime të grupit punues. Po ashtu, kemi mbajtur disa takime me grupet e përfshira në punën për këtë projektligj, si emergjencat rajonale dhe përfaqësuesi i Qendrës Emergjente në QKUK, si dhe përfaqësuesi i Departamentit të Gjendjes Emergjente, në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme. Gjatë kësaj pune, kemi arritur të bëjmë punë të madhe dhe esenciale, që ta bëjmë një ligj sa më të mirë. Gjatë amendamentimit, kemi hasur edhe në disa probleme, të cilat duhet të shqyrtohen edhe më tej. Kemi pasur një vizitë pune edhe në Republikën e Shqipërisë dhe një vizitë në Republikën e Malit të Zi, për të parë edhe përvojën e tyre rreth organizimit të shërbimit emergjent. Kemi marrë disa indikatorë se si mund ta bëjmë këtë ligj më të mirë, por as Republika e Shqipërisë dhe as Republika e Malit të Zi, nuk e kanë të rregulluar në mënyrën më të mirë këtë shërbim dhe ishin në procesin e ndryshimit.

Si grup punues, kemi bërë një numër të konsiderueshëm amendamentesh, por na nevojitet edhe pak kohë që të përfundojmë amendamentimin, në mënyrë që ta bëjmë një ligj sa më funksional. Po ashtu, nevojiten edhe disa konsultime, ndoshta edhe me ndonjë shtet tjetër që e ka të rregulluar më mirë shërbimin emergjent.

Kryetarja – Projektligji ka pasur shumë vërejtje gjatë miratimit në parim në seancë. Pra, është thënë se ka shumë defekte. Kemi parashtruar edhe kërkesë për ministrin e Shëndetësisë, që të ofrojë bashkëpunim dhe ndonjë alternativë ndryshe, që ta kemi një ligj sa më të mirë. Andaj, ne do të punojmë edhe një kohë, të gjithë së bashku, që ta kemi një ligj sa më të mirë.

Fikrim Damka – Grupi punues ka punuar në amendamentimin e këtij projektligji, por është mirë që të punojmë edhe pak dhe të shohim edhe ndonjë mënyrë më funksionale, që ta rregullojmë këtë çështje. Kam pasur një kontakt me drejtorin e përgjithshëm për rastet emergjente në Ministrinë e Shëndetësisë së Turqisë dhe ka ofruar gatishmërinë që të ndihmojnë, jo vetëm në aspektin e ligjbërës, por edhe në aspektin e funksionimit të shërbimit emergjent. Ai ka shprehur gatishmërinë e Turqisë dhe mundësinë që të përgatisim edhe një projekt të përbashkët me Turqinë dhe BE-në, pasi ata janë duke aplikuar projekte në IPA. Mbetet të realizojmë edhe një vizitë studimore në Turqi, bashkë me ministrin e Shëndetësisë të Republikës së Kosovës.

Kryetarja – Turqia kishte ndihmuar edhe Republikën e Malit të Zi në ngritjen e nivelit të shërbimit emergjent në Mal të Zi.

Tani kemi raportimin e grupit të dytë punues, lidhur me monitorimin buxhetor të skemave të asistencës sociale dhe fjalën ia jap kryesuesit të grupit punues, z. Fikrim Damka.

Fikrim Damka – Grupi punues për monitorimin buxhetor të skemave të asistencës sociale ka mbajtur dy takime, ku ka hartuar planin monitorues dhe ka përgatitur pyetjet dhe kërkesën për dokumentacionin e nevojshëm për këtë monitorim buxhetor. Javën e ardhshme, do të kemi edhe një takim me ministrin e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale. Do të informohemi nga ministri për gjendjen aktuale dhe për buxhetin e ndarë për këtë kategori. Pastaj, do të hartojmë raportin me të gjeturat dhe do të diskutojmë në Komision. Në këtë monitorim buxhetor, kemi mbështetje edhe nga OSBE-ja.

Hatim Baxhaku – Edhe grupi punues për amendamentimin e Projektligjit për Shërbimin mjekësor emergjent, ka pasur mbështetje nga OSBE-ja dhe e falënderojmë për mbështetjen.

Kryetarja – Ju falënderoj për raportimin dhe për punën e grupeve punuese. Desha t’ju njoftoj edhe për një takim që kemi mbajtur disa anëtarë të Komisionit, me Bankën Botërore dhe me ministrin e Punës dhe Mirëqenies Sociale, si dhe me shumë organizata joqeveritare, ku është diskutuar për ndryshimet në Ligjin e punës. Në këtë takim, u diskutua mundësia dhe nevoja e ndryshimit të këtij ligji dhe kemi qenë të lidhur me video-link, edhe me grupin e ekspertëve nga Uashingtoni, të cilët kishin analizuar zbatimin e këtij ligji, dhe posaçërisht, ndikimin e pushimit të lehonisë në punësimin e femrave.

Si anëtarë të Komisionit, kemi mbrojtur qëndrimin se duhet të mbrohet kohëzgjatja e pushimit të lehonisë dhe duhet të mbrohet shëndeti i nënës dhe fëmijës. Nuk është e vërtetë që kemi studime që dëshmojnë se pushimi i lehonisë ka shkaktuar rënien e punësimit të grave, përkundrazi në këtë mospunësim ka ndikuar moszbatimi i Ligjit kundër diskriminimit dhe tregu i punës nuk ka qenë në favor as të burrave, as të grave.

Kërkuam nga Banka Botërore të mos na krahasojë me shtetet e Azisë, por të na krahasojë me shtete e rajonit, të cilat shumë më mirë e kanë të rregulluar pushimin e lehonisë.

Gjithashtu, kërkuam nga organizatat joqeveritare të jenë objektive në nxjerrjen e konkluzioneve, ku flitet për pushimin e lehonisë.

4. Të ndryshme

Kryetarja – Për këtë pikë, kam një nismë, e cila i takon fushëveprimit të komisionit tonë. Propozoj që të fillohet nisma për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, invalidëve, veteranëve, pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe familjeve të tyre, që ka të bëjë me afro 150 dëshmorë, që kanë rënë para se të fillonte lufta e UÇK -së, e që kanë mbetur të papërfshirë në ligjin aktual dhe pa iu njohur statusi i tyre. Kjo është një shkelje e të drejtave të tyre, sepse në mesin e tyre ka heronj të popullit dhe persona që kanë buste në qytetet tona, si Zahir Pajaziti, Jusuf Gërvalla dhe shumë të tjerë. Ky numër është i vogël për të mos pasur buxhet, ndërsa janë shumë për moralin tonë për mospranimin e statusit të tyre me ligj, si dëshmorë. Familjet e tyre kanë nisur që t’i kërkojnë të drejtat e tyre, por mendoj se ne duhet të jemi nismëtarët e hartimit të ndryshimit të ligjit për t’ua njohur statusin e tyre. Besoj se do ta mbështesni këtë nismë dhe të vazhdojmë më tutje.

Fikrim Damka – Komisioni duhet të formojë një grup punues, që do të fillojë me plotësim-ndryshimin e ligjit.

Kryetarja – Kjo kërkesë ka qenë edhe gjatë amendamentimit të ligjit që është në fuqi, por për shkak të disa pengesave që kanë ekzistuar në atë kohë, nuk kemi mundur që këtë kategori ta përfshijmë në ligj, por tani gjithsesi duhet që këtë çështje ta fillojmë sa më shpejt, si Komision.

Pas diskutimit, Komisioni mori këtë

V e n d i m

Komisioni të fillojë procedurën për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, invalidëve, veteranëve, pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe familjeve të tyre.

Komisioni emëroi si kryesuese të grupit punues për hartimin e projektligjit për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, invalidëve, veteranëve, pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe familjeve të tyre, deputeten Flora Brovina, ndërsa anëtarë të grupit punues do të jenë të gjithë anëtarët e Komisionit.

Kryetarja – Në këtë pikë kam një sugjerim, që për vizitat e realizuara në Republikën e Shqipërisë dhe në Republikën e Malit të Zi, ta njoftojmë me një raport Kryesinë dhe kryetarin e Kuvendit.

Gjithashtu, propozoi që sipas planit të punës, gjatë javës së ardhshme, të realizojmë edhe një vizitë në SHSKUK, e posaçërisht në Klinikën e Kardiokirurgjisë.

Për fund, dua ta cek edhe një çështje. Siç shihet, punën e Komisionit nuk e pengon mospjesëmarrja e deputetëve të opozitës, por ne na mungojnë koleget tona, të cilat kanë dhënë një kontribut të madh, edhe si kryesuese të grupeve punuese për amendamentimin e projektligjeve që u miratuan në seancën e fundit. Po ashtu, dëshirojmë që ato të mos mungojnë në punën e Komisionit. Këtu nuk përfaqësojmë vetëm partitë tona, por përfaqësojmë popullatën, në një sektor shumë të rëndësishëm, siç është shëndeti i popullatës.

Ju faleminderit për pjesëmarrje.

Mbledhja përfundoi në orën 15:10.

E përqatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetarja e Komisionit

Flora BROVINA